



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

Kryesues i KD-së
Prof. dr. Ali Topalli

Nr. Prot. 479 Dt 15.03.2021

Në bazë të nenit 11 të Rregullores për zgjedhjet e studentëve, themelimin dhe punën e Parlamentit Studentor dhe Këshillat e Studentëve në Universitetin "Isa Boletini", në Mitrovicë, Këshilli Drejtues i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 15.3.2021, mori:

V E N D I M

- I. Shpallen zgjedhjet e studentëve të Universitetit "Isa Boletini", në Mitrovicë, të cilat do të mbahen më 12.04.2021.**
1. Të gjitha organizatat të cilat do të marrin pjesë në zgjedhjet studentore në vitin 2021 duhet të jenë të regjistruara në Ministrinë e Administratës Publike dhe të konfirmuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.
 2. Të gjitha organizatat studentore, të cilat janë regjistruar në mënyrë të rregullt si "shoqatë"- "asociacion" në Ministrinë e Administratës Publike sipas ligjit në fuqi konsiderohen të regjistruara, ndërsa për themelimin e organizatave të reja ato duhet të regjistrohen më së largu deri më 26.03.2021.
 3. Zgjedhjet studentore do të zhvillohen në pajtim me Rregulloren për zgjedhjet e studentëve, themelimin dhe punën e Parlamentit Studentor dhe Këshillat e Studentëve në Universitetin "Isa Boletini", në Mitrovicë dhe sipas planit dinamik të hartuar nga Komisioni i Qendror i Zgjedhjeve.
- II. Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe duhet të shpallet në web faqen e Universitetit të Mitrovicës.**



Prof. dr. Ali Topalli

Kryesues i KD